



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË
INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I PLANIFIKIMI TË MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURËS

Relacion Teknik

Objekti: “Mirëmbajtje e rrugëve Rurale”

Loti I II-të: “Shërbime riparimi dhe mirëmbajtje me stabilizant të rrugëve të pa asfaltuara në Njësitë Administrative”

I. Vendndodhja e Shërbimit

Kontrata e shërbimit shtrihet në tetë njësi administrative të Bashkisë Shkodër. Në bazë të inventarit të rrugëve të Bashkisë Shkodër, gjatësia totale e rrjetit lokal të pa asfaltuar në këto njësi është 382.058 km.

Nr.	Njësia Administrative	Numri I Rrugëve	Gjatësitë e Rrugëve lokale (ml)	Rrugë të Shtruara		Rrugë të Pa Shtruara	
				ml	%	ml	%
1	Qytet	443	202,406	117,613	58%	84,793	42%
2	Rrethina	246	108,000	52,753	49%	55,247	51%
3	Postribë	51	78,239	40,170	51%	38,069	49%
4	Guri I Zi	94	60,046	11,996	20%	48,050	80%
5	Bërdicë	57	30,870	3,087	10%	27,783	90%
6	Dajç	61	61,120	12,224	20%	48,896	80%
7	Velipojë	38	40,370	26,820	66%	13,550	34%
8	Ana e Malit	100	71,170	5,500	8%	65,670	92%
	Shuma	1,090	652,221	270,163		382,058	

II. Synimi i Shërbimit

- Të sigurojë administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së rrugëve, në pronësi të Bashkisë;
- Të përmirësojë rrjetin rrugor të pa asfaltuar, nëpërmjet riparimit të dëmtimeve të shkaktuar nga agjentet atmosferike dhe të ngarkesës së trafikut;
- Të rrisë sigurinë e lëvizjes në rrugë të përdoruesve.

III. Problematika

Infrastruktura rrugore përbën një ndër asetet më të rëndësishme publike të një vendi. Ajo së bashku me transportin kanë një kontribut thelbësor për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Për t'u përballur me kërkesat gjithmonë në rritje që shkaktohen prej rritjes së popullsisë, urbanizimit dhe rritjes së përdorimit të automjeteve, infrastruktura rrugore duhet të zgjerohet dhe zhvillohet. Zgjerimi dhe zhvillimi i saj kërkon investime të konsiderueshme dhe të vazhdueshme të fondeve publike. Ndërtimi i rrugëve të reja është i kushtueshëm, ndërkohë që në mungesë të fondeve për investime të reja dhe domosdoshmërisë për të mbajtur një nivel optimal operimi rrjeti rrugor I pa asfaltuar duhet mirëmbajtur

vazhdimisht. Në mungesë të mirëmbajtjes së rregullt dhe në mënyrën e duhur të tyre, për shkaqe kryesisht të mungesës së fondeve ato shkatërrohen shpejt. Efektet e kombinuara të ngarkesës së trafikut dhe agjentëve atmosferikë dhe mjedisorë bëjnë të mundur shkatërrimin e trupit të rrugës me kalimin e kohës.

Nga një vlerësim teknik i rrjetit të pa asfaltuar në Bashkinë Shkodër janë konstatuar se ka shumë dëmtimeve të niveletës së rrugës dhe kanaleve anësore nga rreshjet e shumta të shiut dhe prurjet anësore të perrenjve, janë krijuar edhe dëmtime teknike në trupin e rrugës të cilat e bëjnë të rrezikshëm kalimin nga automjetet.

Në këto segmente rrugore mungojne kanalet anësore të grumbullimit të ujrave sipërfaqësore dhe ujrave që vijnë nga skarpatat e rrugës dhe që bëjnë largimin e tyre nëpërmjet veprave të artit duke bërë që vetë trupi rrugës të shërbejë si kanal kullues. Përveç mbushjeve me dhera e inerte që kane sjell përrenjtë janë krijuar dëmtime të mëdha në drejtim terthor dhe gjatësor të trupit të rruges duke krijuar vraga të thella të cilat janë bërë shkak për vështirësi qarkullimi të automjeteve. Shtresat me inerte të trupit të rrugës jane gërryer nga ujrata sipërfaqësor që kalojne në niveletën e rrugës duke nxjerre materialet shkembore të cilat vështirësojne së tepërmi levizjen e mjeteve ku në shumë raste rruga mund të jete e kalueshme vetëm me automjete të mëdha.

Të gjitha këto kanë sjell vështirësi të mëdha në qarkullimin e automjeteve si dhe rrezik permanent sigurie kalimi nga përdoruesit e saj.

IV. Realizimi I shërbimit

Punimet e këtij shërbimi konsistojnë në këto procese pune:

- Pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materiale të tjera për sigurimin e një kalimi të sigurt të trafikut. Gjatë heqjes së materialit, profili rrugor nuk duhet të prishet, as të dëmtohen pajisjet e rrugës.
- Pastrimi i kanaleve të kullimit nga depozitimet dhe materialet e ndryshme, duke përfshirë mbledhjen, ngarkimin dhe transportimin e materialit të prishur jashtë rrugës.
- Mbushja dhe nivelimi i bankinave. Bankinat duhet të jetë në gjendje që në çdo moment të shkarkojnë ujin e shiut nga rruga. Sipërfaqet e vogla të deformuara në mbushje do të gërmohen dhe rimbushen për rastet kur këto dëmtime vijnë nga erozioni apo ndonjë shkak tjetër. Nivelimi i sipërfaqeve të pjerrëta duhet të realizohet në mënyrë të tillë që shkalla e pjerrësisë të jetë e përafërt me atë të mbushjes origjinale.
- Skarifikim i sipërfaqeve ekzistuese. Materiali ekzistues do të shkruftohet dhe thërrmohet deri na atë nivel që të mos ketë asnjë copë jashtë standartit të lejuar. Materiali i skarifikuar do rishpërndahet në një mënyrë të tillë që para se të bëhet ngjeshja e sipërfaqes të jetë në përputhje me atë formë përfundimtare siç nevojitet përpara hedhjes së ndonjë materiali shtesë.
- Profilim dhe mbushje e gropave, sigurimin, shtrimin dhe ngjeshjen e stabilizantit për të riparuar rrugët e pashtruara dhe bankinat e tyre.

V. Preventivi i punimeve

Vlera totale e shërbimit është 4,594,800 lekë me tvsh në përputhje me preventivin për të gjithë shërbimin që do të realizoj. Preventivi i punimeve është hartuar në bazë të VKM Nr. 629, datë 15.07.2015

Ky shërbim financohet nga busheti i Bashkisë Shkodër sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 71, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër” .

VI. Afati i Kontratës

Afati I realizmit të shërbimit: 6 muaj nga lidhja e kontratës.

VII. Organizimi i Punimeve.

Për të gjitha proceset e punës, duhet të zbatohen me rigorozitet kushtet teknike të zbatimit të punimeve gjatë ndërtimit dhe të përdoren materiale për ndërtim, sipas standarteve shteterore. Sektori i Planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës harton e ndjek ecurinë e planit të zbatimit të kontratës (një kopje e të cilit do ti dorëzohet kontraktorit në momentin e lidhjes së kontratës), kryen monitorimin e zbatimin e shërbimit.

Sektori i Planifikimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës

Përgjegjes Sektori: Ing. B.Jukni

Specialist: Ing. A.Kraja